



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË



ASCAP

# Raport

**IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE PËR  
ZHVILLIM PROFESIONAL TË  
PUNONJËSVE ARSIMORË NË  
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

20  
21

Raporti "Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar" u zhvillua nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR).

Procesi u koordinua nga:

Gerti Janaqi  
Dorina Rapti  
Albana Markja  
Esion Zgjana  
Erida Koleci  
Evis Mastori

Për realizimin e këtij procesi falënderojmë Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP), Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), Zyrat Vendore Arsimore (ZVA) dhe në mënyrë të veçantë të gjithë drejtuesit dhe mësuesit që morën pjesë në plotësimin e instrumentit.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ASCAP. Përmbajtja e këtij raporti mund të përdoret ose të kopjohet për qëllime studimi nga individë ose organizata të ndryshme, me kusht që të respektohen të drejtat e autorit.

Janar, 2021  
Tiranë

# TABELA E PËMBAJTJES

**1**

HYRJE

**2**

METODOLOGJIA

**3**

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË PJESËMARRËSVE

**4**

REZULTATET E INSTRUMENTIT

**5**

KONKLUZIONE

**6**

REKOMANDIME

# HYRJE

1

Njohuritë, aftësitë, angazhimi i mësuesve, si dhe cilësia e drejtimit të shkollës janë faktorët më të rëndësishëm në arritjen e rezultateve të larta në sistemin arsimor. Mësimdhënia cilësore dhe aftësia e mësuesve për të motivuar dhe për të frymëzuar të gjithë nxënësit që të arrijnë më të mirën e tyre, ka ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në të ardhmen e fëmijëve dhe të rinjve.

Për këtë arsye, është thelbësore që mësuesit jo vetëm të kenë arsimimin e përshtatshëm dhe përgatitje të lartë profesionale gjatë formimit fillestar të tyre, por për të përmbushur sa më mirë detyrat, duhet të sigurojnë standarde të larta të zhvillimit të vazhdueshëm profesional në të gjitha nivelet. Nga ana tjetër, kjo kontribuon edhe në rritjen e statusit të këtij profesioni të rëndësishëm.

Ashtu si shumë shtete europiane dhe botërore, edhe Shqipëria ka ndryshuar kurrikulën në sistemin arsimor, e cila tashmë ka një qasje të re. Thelbi i kësaj qasjeje është se bazë për marrjen e njohurive të reja duhet të jenë kompetencat individuale të çdo nxënësi dhe eksperiencia e tij. Në praktikë, kjo do të thotë që çdo nxënës duhet të marrë vëmendje individuale, detyra të personalizuar dhe mundësi për të rikrijuar procesin e tij të të nxënit. “Mëso duke bërë” është fokusi i kësaj qasjeje, e cila ndryshon nga mësimdhënia tradicionale ku mësuesit transferojnë njohuritë e tyre në mënyrë të njëjtë të të gjithë nxënësit.

Bazuar në udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017 të ministrit të Arsimit dhe të Sportit “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, ASCAP në bashkëpunim me MASR-në, nisur nga prioritetet për vitin 2020-2021, organizoi punën për kryerjen e identifikimit dhe të grumbullimit të nevojave për zhvillim profesional të mësuesve dhe të drejtuesve. Për ta bërë sa më gjithëpërfshirës këtë proces, u përfshinë të gjithë aktorët e pranishëm në shkollë dhe që kontribuojnë në sistemin arsimor. Gjithashtu, për realizimin e këtij procesi u morën parasysh edhe të dhënat e grumbulluara nga komisioni i akreditimit të programeve/moduleve të trajnimit (KAPT) mbi ecurinë dhe llojshmërinë e aktiviteteve për zhvillim profesional, të ndërmarra gjatë katër viteve të fundit nga institucione partnere dhe agjenci trajnuese që kanë kontribuar në këtë fushë.

## 1.1. Procesi i identifikimit të nevojave

Identifikimi dhe analiza e nevojave përfaqëson hapin e parë të çdo vendimmarrjeje apo ndërhyrjeje. Edhe në sistemin arsimor parauniversitar, identifikimi dhe analiza e nevojave përbën një nga proceset e rëndësishme dhe të domosdoshme për vendimmarrjet e mëtejshme sidomos në fushën e zhvillimit profesional të stafëve mësimore. Më konkretisht, identifikimi i nevojave të punonjësve arsimorë përmbledh përcaktimin e gjendjes reale të aftësive, njohurive dhe shprehive të këtij grupi, krahasuar me standardet profesionale që duhet të demonstrojë mësuesi gjatë procesit mësimor.

Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017 të ministrit të Arsimit dhe të Sportit “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”, procesi i identifikimit të nevojave të punonjësve arsimorë bëhet çdo katër vjet. Ai është një proces që bëhet në bashkëpunim me DPAP-në, DRAP-et, ZVA-të, si dhe institucionet arsimore parauniversitare. Siç duket, procesi është i gjerë dhe gjithëpërfshirës. Ai shtrihet në gjithë hierarkinë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, duke mundësuar një “skanim” tërësor të nevojave dhe të gjendjes në këtë moment, të situatës në sistem.

Gjatë procesit të identifikimit dhe të analizës së nevojave të punonjësve arsimorë merren në konsideratë qëllimi i paracaktuar për këtë proces, informacione dhe të dhëna mbi situatën në të cilën është reforma në arsim, si dhe klima që mbizotëron dhe ekuilibrat e brendshme e të jashtme të sistemit arsimor. Shumë e rëndësishme është që gjatë këtij procesi të bëhet një dallim i qartë mes nevojave momentale dhe perceptimit të nevojave në funksion të së ardhmes.

# METODOLOGJIA

Disa nga teknikat bazë me anë të të cilave mund të realizohen proceset e identifikimit dhe të analizës së nevojave përfshijnë: vëzhgimet, pyetësorët, intervistat, konsultat me persona në pozicione kyç ose me persona të cilët zotërojnë njohuri specifike, si dhe të dhënat dhe raportet e studimeve të ndryshme.

Duke u nisur nga synimi që të identifikohen nevojat për çdo punonjës arsimor apo për pjesën më të madhe të tyre, si dhe nga përfshirja në analizë e një numri sa më të madh fushash e çështjesh që lidhen me aftësitë profesionale të punonjësve arsimorë, arrihet në përfundimin që pyetësi është teknika më efektive për të mundësuar një identifikim të gjendjes reale të nevojave.

Për të qenë sa më funksional, identifikimi i nevojave është një proces, i cili integron format formale të orientuara drejt mbledhjes së të dhënave përmes instrumenteve përkatëse dhe format informale të komunikimit me të gjithë aktorët në DPAP, DRAP-e, ZVA dhe shkolla.

## 2.1 Qëllimi dhe objektivat

Qëllimi i procesit të identifikimit të nevojave për trajnim të punonjësve arsimorë është ***përcaktimi i nevojave për zhvillim profesional për punonjësit arsimorë në nivel shkolle, ZVA-je, DRAP-i, si dhe në nivel kombëtar.***


Objektivat e këtij procesi janë:

- Identifikimi i gjendjes reale të punonjësve arsimorë në sistemin arsimor parauniversitar për përmirësimin e aftësive, njohurive dhe shprehive të nevojshme.
- Evidentimi i fushave/çështjeve prioritare të nevojshme për të mbështetur zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë.
- Rekomandimi i drejtimeve të ndërhyrjes dhe të mbështetjes nga institucionet që mbështesin reformat në sistemin arsimor parauniversitar.
- Mbështetja e dokumenteve strategjike në fushën e arsimit parauniversitar për të siguruar ecurinë e duhur në fushën e reformave në arsim.

Përfundimet e këtij raporti do të kontribuojnë në pritshmërinë e aktorëve të ndryshëm mbi nevojat për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë dhe përditësimin e aftësive të tyre, lidhur me fushat e instrumentit.

Ne besojmë se pika e fillimit për përmirësimin e vazhdueshëm të aftësive të mësuesve fillon pikërisht nga identifikimi i nevojave për përmirësim, planifikimi në përputhje me parimet e kurrikulës, si dhe zbatimi i veprimtarive në mënyrë të vazhdueshme si pjesë e qenësishme e institucionit arsimor.

Ky raport do të ndihmojë drejtuesit e institucioneve arsimore dhe stafin mësimdhënës, të cilët për një arsye ose një tjetër kanë qenë më pak efektivë, të punojnë në mënyrë më eficiente në përmirësimin e performancës së institucionit të tyre.



## 2.2 Qasja e raportit

Çështjet e ngritura në raportin “Identifikimi i nevojave për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar” kanë të bëjnë me rolin e rëndësishëm të drejtuesit dhe të stafit të shkollës në planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës me kompetenca, përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor, mësimdhënien dhe të nxënit, përkujdesjen për nxënësit me vështirësi në të nxënë, vlerësimin e të nxënit, etikën dhe komunikimin, bashkëpunimin me komunitetin, gjithëpërfshirjen dhe krijimin e një klime miqësore për zhvillimin e shkollës.

Raporti bazohet në kërkim sasior, pasi është një nga mënyrat më efektive që përdoret për mbledhjen e një sasive të madhe të dhënash nga terreni.

## 2.3 Popullata dhe përzgjedhja e kampionit

Popullata në këtë raport është rreth 28000 drejtues dhe mësues në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parashkollor, të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm, në 4 DRAP-et dhe në 51 ZVA-të e vendit. Gjithsej në studim morën pjesë **20288 pjesëmarrës (drejtorë, nëndrejtorë dhe mësues) që përbëjnë rreth 72% të popullatës.**

Sipas Sowell (2001), përzgjedhja rastësore është një teknikë e mirë pasi siguron një kampion përfaqësues të popullatës së synuar dhe parashikon bazat e kërkuesit për të hyrë në procesin e përzgjedhjes. Arsyja kryesore e kësaj është se çdo anëtar i popullatës ka mundësi të barabarta për të qenë i përzgjedhur dhe për të qenë pjesë e kampionit. Gorard (2003) mendon se kampioni lejon që kërkuesi të zgjedhë me një ose dy karakteristika të popullatës, për të arritur cilësi të lartë të kampionit.

Nën këtë koncept, në përzgjedhjen e stafit të shkollës u morën në konsideratë dy karakteristika: së pari që ata të jenë nga të gjitha fushat e të nxënit dhe së dyti të jenë nga të të gjitha ciklet e arsimit (arsim parashkollor, arsim fillor, arsimi i mesëm i ulët dhe arsim i mesëm i lartë).

## 2.4 Mbledhja e të dhënave dhe instrumenti

Mbledhja e të dhënave u realizua në një periudhë 4- ditore, gjatë muajit nëntor 2020. Përpara realizimit të procesit u komunikua me organet drejtuese të njësive arsimore vendore, për administrimin e instrumentit me stafin e institucioneve arsimore.

Në fillim u realizua prezantimi i qëllimeve të raportit. Të gjithë pjesëmarrësve iu bë e qartë që të dhënat që do të dalin nga ky raport janë vetëm për objekt identifikimi nevojash për zhvillim profesional dhe janë anonime. Më pas pjesëmarrësve iu kërkua plotësimi i instrumentit në mënyrë sa më reale. U theksua se plotësimi i instrumentit nga ana e pjesëmarrësve do të kryhet në mënyrë të pavarur, pra çdo pjesëmarrës do ta plotësojë në mënyrë individuale instrumentin, pa ndërhyrjen e faktorëve të tjerë të jashtëm.



Ky instrument u organizua në tri rubrika kryesore:

- Rubrika e parë mblodhi informacion për të dhënat demografike të pjesëmarrësve.
- Rubrika e dytë mblodhi informacion për identifikimin e nevojave të zhvillimit profesional të punonjësve arsimorë mbi bazën e disa fushave, të cilat u referohen standardeve të përgjithshme të mësuesit.
- Rubrika e tretë mblodhi informacion për nevojat më prioritare për zhvillimin individual profesional, parë nga këndvështrimi i pjesëmarrësve.

Secila nga fushat përmbledh disa çështje, të cilat orientojnë hartimin dhe strukturën e instrumentit.

## FUSHAT

### Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca

- Planifikimi i kurrikulës sipas nevojave të nxënësve.
- Kompetencat kyç, kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit.
- Burimet e të nxënit.
- Planifikimi i veprimtarive mësimore.
- Sigurimi i koherencës së planifikimit.
- Planifikimi për zhvillimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet platformave online si burime të nxëni.

### Mësimdhënia dhe të nxënit

- Metodologjitë e mësimdhënie-nxënies.
- Zhvillimi i kompetencave kyç dhe i aftësive parësore (*soft skills*).
- Vlerësimi i të nxënit.
- Teknikat e të pyeturit dhe diskutimet.
- Përdorimi i situatave nga jeta reale në përvetësimin e njohurive dhe të aftësive;
- Përdorimi i platformave online si metodologji mësimdhënieje.
- Menaxhimi i klasës dhe i sjelljes së nxënësve.
- Mjedisi fizik i klasës.
- Klima në klasë.

### Etika dhe komunikimi

- Kodi i etikës.
- Komunikimi me nxënësit.
- Komunikimi me prindërit.
- Komunikimi me kolegët.
- Bashkëpunimi me komunitetin.
- Partneriteti mësues-nxënës -prindër.

### Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës

- Koncepti i gjithëpërfshirjes.
- Pëngesat në procesin e të nxënit dhe në pjesëmarrjen aktive.
- Burimet për të mbështetur procesin e të nxënit dhe pjesëmarrjen.
- Përkrahja e diversitetit.
- Nevojat e veçanta në shkollë.
- Mjedisi miqësor.
- Bullizmi.
- Integrimi në shkollë.

Instrumenti përmban 30 kërkesa me alternativa që vlerësohen me 1 pikë secila, pra gjithsej 30 pikë. Kërkesat e instrumentit fokusohen kryesisht në situata nga konteksti real i shkollës.

## 2.5 Analiza e mbledhjes së të dhënave

Të dhënat sasiore u mbledhën përmes një instrumenti të përshtatur në platformën online google forms, për një periudhë 4- ditore. Pjesëmarrësit që u përfshinë në proces ishin nga shkolla publike dhe private. Ata u njohën me rezultatin menjëherë pas përfundimit të instrumentit.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID -19, pjesëmarrësit u kontaktuan me email për të marrë pjesë në këtë proces dhe përmes platformës Zoom u prezantua qëllimi i raportit dhe instrumenti përkatës. Një letër motivuese (*shtojca 1*), e cila përfshin të gjitha informacionet etike dhe të nevojshme, iu bashkëngjiti instrumentit (*shtojca1*).

Për kryerjen e analizave të studimit u përdorën metodat statistikore. Fillimisht, pas mbledhjes së të dhënave, u realizua kodimi i tyre dhe më pas u ndërtua baza e të dhënave duke krijuar një nga faqet e programit SPSS, versioni 17.

Për analizën e rubrikës së parë dhe të dytë të instrumentit u përfshinë madhësia e kampionit, frekuencat, mesataret, variancat dhe devijimet standarde.

Për rubrikën e tretë u zhvilluan analiza përshkruese dhe u përmbledhën të dhënat e shkruara nga pjesëmarrësit.

## 2.6 Konsiderata etike

Përgjatë këtij procesi u zbatuan të gjitha standardet etike. Autorët e raportit respektuan të drejtat, privatësinë, dinjitetin dhe ndjeshmërinë e pjesëmarrësve që morën pjesë në këtë proces. I gjithë informacioni që u mor nga pjesëmarrësit, është anonim.

Autorët morën angazhim që të gjitha të dhënat të jenë të mbrojtura dhe të jenë për përdorim vetëm për personat e autorizuar nga ASCAP që ka përgjegjësinë ta kryejë këtë proces dhe të hartojë këtë raport.

## 2.7 Përpunimi i të dhënave

Pas përfundimit të procesit, të dhënat e grumbulluara iu nënshtruan procesit të pastrimit dhe të pikëzimit në programin SPSS. Më pas, me të dhënat e përfutuara u krijua një *datbazë* me rubrikat si më poshtë:

- DRAP-i në të cilin përfshihet shkolla.
- ZVA që i përket shkolla.
- Emri i shkollës.
- Lloji i shkollës;
- Vendndodhja e shkollës (fshat/qytet).
- Gjinia e pjesëmarrësit (F/M).
- Pozicioni i pjesëmarrësit (drejtor/nëndrejtor/mësues).
- Lloji i shkollës (publike, private).
- Profili /lënda që jep mësim.
- Cikli arsimor ku përfshihet lënda.
- Kategoria e kualifikimit të pjesëmarrësit.
- Vjetërsia në punë (në vite).
- Pikët për çdo fushë vlerësimi.
- Pikët totale të fituara.

Përpunimi i të dhënave u realizua nga përdorimi i programeve SPSS dhe Excel.

Në këtë raport statistikat janë shprehur në formë tabelare ose grafike. Statistika e përdorur është numri i mësuesve/përqindja e mësuesve, të klasifikuar sipas katër niveleve të rezultateve:

### NIVELI 1

Ka rezultate të pakënaqshme dhe nevoja të domosdoshme për përmirësim.

### NIVELI 2

Ka nevoja të konsiderueshme për përmirësim.

### NIVELI 3

Ka rezultate të kënaqshme dhe nevoja për përmirësim.

### NIVELI 4

Ka rezultate shumë të kënaqshme.

# TË DHËNAT DEMOGRAFIKE TË PJESËMARRËSVE





Nga përpunimi i të dhënave demografike rezulton se instrumenti është plotësuar gjithsej nga 20288 pjesëmarrës. Instrumenti është plotësuar kryesisht me smartphone (aparati celular) nga 94.8 % e pjesëmarrësve, ndërsa 2.3% e pjesëmarrësve e kanë plotësuar nga kompjuteri.

Grafiku 1: Aparati digjital me të cilin është plotësuar instrumenti.




Tabela 1 paraqet numrin e pjesëmarrësve sipas kategorive: *fshat/qytet*; *femra/meshkuj*; *publike/private*. 97.1% e pjesëmarrësve janë nga shkolla publike.

Tabela 1: Numri i pjesëmarrësve sipas vendndodhjes, gjinisë dhe llojit të shkollës


<b>Vendndodhja e shkollës</b>		Fshat	10523
		Qytet	9765
<b>Gjinia e mësuesit</b>		Femra	16191
		Meshkuj	4097
<b>Lloji i shkollës</b>		Publike	19705
		Private	583
		<b>Totali</b>	<b>20288</b>

Në grafikun 2 paraqiten të dhënat e pjesëmarrësve sipas pozicionit aktual në shkollë. Nga grafiku duket se 92.1% e pjesëmarrësve janë mësues/mësues ndihmës, 6.8% e tyre janë drejtues dhe 1.1% janë staf mbështetës.

Grafiku 2: Pozicioni në shkollë i pjesëmarrësit




Nga përpunimi i të dhënave demografike sipas DRAP-eve rezulton se pjesëmarrja ka qenë e konsiderueshme në të gjitha DRAP-et e vendit në përputhje me numrin e punonjësve arsimorë që ka secili DRAP. Të dhënat paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Grafiku 3: Pjesëmarrja sipas DRAP-eve


Të dhënat e pjesëmarrësve për çdo DRAP dhe çdo ZVA paraqiten në grafikun 4, më poshtë.

Grafiku 4: Pjesëmarrja për çdo DRAP dhe çdo ZVA



Pjesëmarrësit në proces ishin nga të gjitha profilet e institucioneve arsimore, përfshirë edhe arsimin parashkollor, shkollat me drejtim të orientuar, shkollat profesionale, si dhe shkollat speciale. Të dhënat përmbledhen në grafikun 5, më poshtë.


Grafiku 5: Pjesëmarrja sipas profilit të institucionit






Një nga kërkesat e plotësimit të instrumentit ishte edhe përbërja e pjesëmarrësve nga të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar. Të dhënat paraqiten në grafikun më poshtë:

Grafiku 6: Pjesëmarrja sipas cikleve



Pjesëmarrësit në procesin e identifikimit të nevojave ishin të moshave të ndryshme, përfshirë edhe mësuesit me shumë vite eksperiencë. Në grafikun më poshtë pasqyrohen të dhënat e pjesëmarrësve sipas kategorisë. Numri më i madh i pjesëmarrësve janë mësues/drejtues të kategorisë së dytë.


Grafiku 7: Pjesëmarrja sipas kategorisë



- Nuk kam kategori (23.55%)
- Mësues mjeshtrë (Kategoria I) (29.44%)
- Mësues specialist (Kategoria II) (31.39%)
- Mësues i kualifikuar (Kategoria III) (15.62%)

Sipas kërkesës së plotësimit të instrumentit, pjesëmarrësit ishin të të gjitha lëndëve/profileve. Në grafikun më poshtë janë përmbledhur të gjitha të dhënat që lidhen me lëndën/profilin e pjesëmarrësve.

Grafiku 8: Pjesëmarrja sipas lëndëve/profileve




# REZULTATET E INSTRUMENTIT

Rubrika e dytë e instrumentit kishte për qëllim të vlerësonte njohuritë dhe aftësitë e punonjësve arsimorë në situata konkrete nga jeta reale e punës në shkollë. Fushat/çështjet në instrument bazohen në standardet e përgjithshme të mësuesit dhe janë kyç e të domosdoshme për zhvillimin profesional të mësuesve me qëllim sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

## 4.1 Rezultatet e përgjithshme

Rezultatet e vlerësimit të përgjithshëm të mësuesve në nivel kombëtar, të paraqitura grafiksht në grafikun 9, tregojnë se: vetëm 22.5% e mësuesve zotërojnë njohuri dhe aftësi të nivelit shumë të kënaqshëm; 53.7% e mësuesve zotërojnë njohuri dhe aftësi të nivelit të kënaqshëm, por me nevoja për përmirësim; 20.9% e mësuesve zotërojnë njohuri dhe aftësi që kanë nevoja të konsiderueshme për përmirësim; 2.8% e mësuesve zotërojnë njohuri të nivelit të pakënaqshëm me nevoja të domosdoshme për përmirësim.


Grafiku 9: Rezultatet e përgjithshme sipas niveleve



Informacioni rreth rezultateve të mësuesve në nivel kombëtar është paraqitur edhe në grafikun 10, i cili paraqet shpërndarjen e pikëve totale të fituara nga mësuesit për katër fushat e instrumentit. Në shpërndarjen normale plotësohet kushti *mesatarja=median=moda*. Shihet se grafiku paraqet një shpërndarje normale (në vlera  $20.8 \approx 21=21$ ) me përjashtim të vlerave 29 dhe 30 pikë. Nga leximi i grafikut shihet se mesatarja e pikëve të fituara nga mësuesit ( $A= 20.86$ ) është më e madhe se mesatarja e pikëve totale të instrumentit ( $B=15$ ). Kjo situatë shpjegohet me faktin se pritshmëria e rezultateve të vlerësimit ishte që të gjithë mësuesit të kishin fituar pikë mbi mesataren e pikëve të instrumentit.


Grafiku tregon se ka mësues, të cilët janë vlerësuar me pikë që ndodhen në intervalin 1-15 pikë. Këta përbëjnë rreth 12.8% të mësuesve, ndërkohë ka dhe një numër të konsiderueshëm që janë vlerësuar me 30 pikë (7.8%)

Prania e mësuesve që janë vlerësuar me pikë maksimale tregon se kjo kategori mësuesish është e përgatitur dhe zotëron njohuri e aftësi të përditësuara për katër fushat bazë të vlerësimit



Nga të dhënat e paraqitura në grafikun 11 rezulton se në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” mësuesit paraqesin rezultate më të dobëta. 69.2% e pjesëmarrësve janë në nivelet 1 dhe 2, duke paraqitur nevoja të domosdoshme për zhvillim profesional. Rezultate të dobëta ka edhe fusha “Mësimdhënia dhe të nxënit”, ku vetëm 18.1% e mësuesve paraqesin rezultate shumë të kënaqshme.


Grafiku 11: Rezultatet për çdo fushë dhe çdo nivel



	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Niveli 4
<b>Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca</b>	<b>8,40%</b>	<b>28,90%</b>	<b>35,30%</b>	<b>27,30%</b>
<b>Mësimdhënia dhe të nxënit</b>	<b>12,80%</b>	<b>34,70%</b>	<b>34,40%</b>	<b>18,10%</b>
<b>Etika dhe komunikimi</b>	<b>2,90%</b>	<b>12,60%</b>	<b>29,70%</b>	<b>54,90%</b>
<b>Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës</b>	<b>20,60%</b>	<b>48,60%</b>	<b>14,60%</b>	<b>16,20%</b>


Lidhur me rezultatet e pjesëmarrësve sipas vendndodhjes së shkollës, në grafikun 12 vihet re që në nivelin e katërt, *me rezultate shumë të kënaqshme*, janë në mënyrë të barabartë edhe mësuesit e zonave urbane edhe mësuesit e zonave rurale (22.63% dhe 22.45%). Në nivelin e tretë, *me rezultate të kënaqshme*, paraqiten më mirë mësuesit e shkollave në zonat urbane 55.31% përkundrejt 52.03%. Ndërkohë në nivelin e parë, *me nevoja të domosdoshme për përmirësim*, paraqiten njësoj, me diferenca shumë të vogla, mësuesit e të dyja zonave: urbane dhe rurale (2.91% dhe 2.67%).

Grafiku 12: Rezultatet sipas zonave urbane dhe rurale




Nëse krahasojmë rezultatet e mësuesve të shkollave publike dhe të shkollave private rezultojnë se në nivelin 4, *me rezultate shumë të kënaqshme*, janë 22.5% e mësuesve të shkollave publike dhe me rezultat të përafërt janë edhe mësuesit e shkollave private (23.8%). Ndërkohë në nivelin 1, me rezultate të pakënaqshme mësuesit e shkollave private kanë përqindje më të lartë 4.8% krahasuar më mësuesit e shkollave publike (2.7%).

Grafiku 13: Krahasimi i rezultateve të mësuesve në publike dhe private




Nga analiza e të dhënave për çdo DRAP dhe nivelet përkatëse mund të themi se të gjitha DRAP-et kanë rezultate të përafërta. DRAP Lezhë ka përqindje më të lartë në nivelin e parë (3.66% e pjesëmarrësve) dhe në nivelin e dytë (23.35% e pjesëmarrësve), që do të thotë se mësuesit kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim të aftësive. DRAP Fier ka rezultatet më të larta në nivelin e katërt, me 24.03% të pjesëmarrësve, pra me rezultate shumë të kënaqshme. Në nivelin e tretë paraqitet me rezultate më të mira DRAP Durrës me 54.85%, pasuar nga DRAP Korçë me 53.74%.

Grafiku 14: Rezultatet për DRAP-et, sipas niveleve



Nëse do të krahasojmë rezultatet e mësuesve referuar gjinisë, shihet se femrat kanë vlerësime më të larta kundrejt meshkujve (*shihni grafikun 15*). Mësueset femra kanë marrë vlerësime më të larta për nivelin 4 dhe për nivelin 3, ku përqindja e tyre shkon në 78.31% kundrejt 68.24% të meshkujve. Ndërkohë që 6.22% e mësuesve meshkuj kanë marrë vlerësime të pakënaqshme, përkundrajt 1.93% e mësueseve femra.

Grafiku 15: Rezultatet sipas gjinisë dhe niveleve




Nga analiza e rezultateve në tabelën e mëposhtme rezulton:

- **Kategori – nivel:** Mësuesit që nuk kanë kategori, d.m. th., me më pak se 5 vjet punë si mësues, janë në nivelin e tretë dhe në nivelin e dytë (75.47%), pra me nevoja për përmirësim. Ndërkohë që 4.29% e mësuesve të kësaj kategorie janë në nivelin e parë, *me nevoja të konsiderueshme për përmirësim*. Po të njëjtat rezultate kanë edhe mësuesit e kategorisë së tretë, 76.14% e të cilëve janë në nivelin e tretë dhe në nivelin e dytë. Për mësuesit e kategorisë së dytë mund të themi se 81.73% e tyre janë në nivelin e katërt dhe të tretë dhe vetëm 1.87% janë në nivelin e parë. Po kështu edhe mësuesit e kategorisë së parë janë më së shumti në nivelin e katërt dhe të tretë me 76.92% të tyre. Vetëm 2.48% e mësuesve të kësaj kategorie janë në nivelin e parë.
- **Nivel – kategori:** Nëse do të analizonim mësuesit që kanë dalë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, mund të themi se mësuesit pa kategori kanë përqindjen më të lartë në këto nivele. Ndërkohë në nivelin e tretë dhe në nivelin e katërt ndodhen më së shumti mësuesit e kategorisë së dytë, të pasuar nga mësuesit e kategorisë së parë.

	Nuk kam kategori	Mësues mjeshtër (Kategoria I)	Mësues specialist (Kategoria II)	Mësues i kualifikuar (Kategoria III)	Totali
<b>Niveli 1 (Të pakënaqshme)</b>	205	148	119	95	567
% për kategori	4,29%	2,48%	1,87%	3,00%	2,79%
% total	1,00%	0,70%	0,60%	0,50%	2,80%
<b>Niveli 2 (Ka nevojë për përmirësim)</b>	1263	1237	1045	702	4247
% për kategori	26,44%	20,71%	16,41%	22,15%	20,93%
% total	6,20%	6,10%	5,20%	3,50%	20,90%
<b>Niveli 3 (Të kënaqshme)</b>	2342	3279	3569	1711	10901
% për kategori	49,03%	54,90%	56,04%	53,99%	53,73%
% total	11,50%	16,20%	17,60%	8,40%	53,70%
<b>Niveli 4 (Shumë të kënaqshme)</b>	967	1309	1636	661	4573
% për kategori	20,24%	21,92%	25,69%	20,86%	22,54%
% total	4,80%	6,50%	8,10%	3,30%	22,50%
<b>Totali</b>	4777	5973	6369	3169	20288
% për kategori	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%	100,00%
% total	23,50%	29,40%	31,40%	15,60%	100,00%




Grafiku 16: Rezultatet e mësuesve sipas kategorisë dhe sipas niveleve




Grafiku 17 paraqet shpërndarjen e DRAP-eve duke iu referuar mesatares së pikëve të fituara nga mësuesit kundrejt mesatares në nivel kombëtar (20.86 pikë).

DRAP-et që kanë mesatare pikësh më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar janë DRAP Fier dhe DRAP Korçë. Vlerën më të lartë të mesatares së pikëve e ka arritur DRAP Fier me 21.0, ndërsa DRAP-i që ka mesatare pikësh më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar është DRAP Lezhë. DRAP Durrës ka një mesatare pikësh të njëjtë me mesataren në nivel kombëtar.

Grafiku 17: Shpërndarja e DRAP-eve duke iu referuar mesatares së pikëve përkundërt mesatares në nivel kombëtar




Grafiku 18: Shpërndarja e ZVA-ve duke iu referuar mesatares së pikëve përkundrejt mesatares në nivel kombëtar



Grafiku 18 paraqet shpërndarjen e ZVA-ve, referuar mesatares së pikëve të fituara nga mësuesit kundrejt mesatares në nivel kombëtar (20.86 pikë).


- ZVA-të që kanë mesatare pikësh më të lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar janë ZVA-të: Kolonjë, Divjakë, Delvinë- Finiq, Kavajë, Përrenjas etj.
- Ndërsa ZVA-të që kanë mesatare pikësh më të ulët sesa mesatarja në nivel kombëtar janë ZVA-të: Librazhd, Bulqizë, Klos, Roskovec, Has, Tepelenë etj.
- ZVA-të: Fier, Elbasan, Krujë, Cërrik, Belsh, Korçë, Krujë, Lezhë, Mat, Pogradec, Përmet, Tiranë etj., kanë një mesatare pikësh të njëjtë me mesataren në nivel kombëtar.

Grafiku 19: Mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve



Grafiku 19 më sipër tregon mësuesit e cikleve shkollore sipas niveleve përkatëse. Nga të dhënat në grafik rezulton se në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, *me rezultatet që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim*, mësuesit e ciklit të arsimit parashkollor kanë përqindjen më të lartë (44.9%), të pasuar nga mësuesit e arsimit fillor me 27.1%, mësuesit e ciklit të AMU+AML-së me 26.9% etj. Ndërkohë në nivelin e katërt, *me rezultate shumë të kënaqshme*, paraqiten mësuesit e AML-së me 26.2%, të pasuar nga mësuesit e AMU-së me 23.6% etj.


Grafiku 20: Rezultatet drejtues dhe mësues për secilin nivel



Në grafikun 20 paraqiten rezultatet e përgjithshme të drejtuesve dhe të mësuesve për secilin nivel. Nga grafiku duket se në nivelin e katërt me rezultate të kënaqshme janë më së shumti nëndrejtorët me 37.9%, ndërsa në nivelin e parë dhe të dytë janë mësuesit ndihmës me 32.2%.

Grafiku 21 tregon mësuesit e profileve/lëndëve sipas niveleve përkatëse. Nga të dhënat në tabelë rezulton se në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, *me rezultate që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim*, mësuesit e arsimit parashkollor kanë përqindjen më të lartë (44.9%), të pasuar nga mësuesit e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit me 35.3%, mësuesit e ekonomisë me 33.8%, mësuesit e arsimit fillor me 27.1%, mësuesit e arteve etj. Ndërkohë në nivelin e katërt me rezultate shumë të kënaqshme paraqiten mësuesit e lëndëve: Kimi -26.5%; Matematikë- 26%; Histori- 23.9%; Gjuhë shqipe- 23.6%.

Grafiku 21: Mësuesit sipas profileve/lëndëve dhe niveleve



## 4.2 Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”


Fusha “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” ka vlerësuar nevojat e mësuesve për trajnim lidhur me planifikimin e kurrikulës sipas nevojave të nxënësve; zhvillimin e kompetencave kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave lëndore, planifikimin e veprimtarive mësimore, sigurimin e koherencës mes planifikimeve vjetore, të periudhës dhe ditore, planifikimin për zhvillimin e procesit të mësimdhënies nëpërmjet platformave online si burime të nxëni.

Në nivel kombëtar mesatarja e pikëve në fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” është 6.2, ndërkohë pikët maksimale në këtë fushë janë 9 pikë.

Nga krahasimi i informacionit të paraqitur në grafikun 22 me informacionin e paraqitur në grafikun 11 rezulton se numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe nivelin 2 për fushën e planifikimit (37.3%) është ndjeshëm më i lartë kundrejt numrit të mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe 2 në vlerësimin e përgjithshëm (23.7%), (shihni tabelat në shtojcën 1).


Këto shifra tregojnë se rreth 37.3% e mësuesve zotërojnë informacion jo të mjaftueshëm për çështje që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës me kompetenca.

### Grafiku 22: Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”




Grafiku 23 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga mësuesit për fushën e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës me kompetenca. Shihet se numri i mësuesve të vlerësuar me pikët maksimale të kësaj fushe (9 pikë) është i ulët (3198). Pjesa më e madhe e mësuesve, 10654 mësues ose 52.6%, janë me 5-7 pikë. Grafiku paraqet një shpërndarje normale të anuar pak nga e majta (në vlera  $6.2 \approx 6 = 6$ ). Grafikisht shihet se mesatarja e pikëve të fituara nga mësuesit (6.17) është më e lartë se mesatarja e pikëve të instrumentit për fushën e planifikimit (4.5).

Grafiku 23: Shpërndarja e pikëve të fituara për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”




Grafiku 24: Fusha “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” për çdo DRAP



Grafiku 24 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” për çdo DRAP. Nga të dhënat duket qartë që ashtu si në vlerësimet e përgjithshme edhe në vlerësimet e kësaj fushe, mësuesit në të gjitha DRAP-et janë në nivelin e dytë dhe të tretë. Mësuesit e DRAP-it Fier dhe të DRAP-it Lezhë kanë përqindjen më të lartë në nivelin e pakënaqshëm dhe kanë nevojë për përmirësim.

Grafiku 25 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” për zonat urbane dhe rurale. Ashtu si për vlerësimin e përgjithshëm, edhe për fushën e planifikimit rezultojnë se mësuesit e shkollave të zonave urbane kanë rezultate më të larta kundrejt mësuesve të shkollave të zonave rurale dhe kjo veçanërisht referuar numrit të mësuesve që janë vlerësuar me nivelin 3 dhe nivelin 4, me rezultate të kënaqshme dhe shumë të kënaqshme.


Grafiku 25: Planifikimi dhe zbatimit i kurrikulës me kompetenca sipas zonës (rurale/urbane)



Grafiku 26 tregon mësuesit e profileve /lëndëve sipas niveleve përkatëse në fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”. Nga të dhënat grafike rezultojnë se përqindje më të lartë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, me rezultate që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim, kanë mësuesit e arsimit parashkollor, mësuesit e gjuhëve të huaja, mësuesit e arteve, mësuesit e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit etj.




Grafiku 26: Mësuesit sipas profileve/lëndëve dhe niveleve në fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”




Grafiku 27 tregon mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve përkatëse në fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”. Nga të dhënat grafike vihet re që në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, me rezultate që kanë nevojë të domosdoshme për përmirësim, rezultojnë mësuesit e arsimit parashkollor, mësuesit e arsimit special, mësuesit e AMU+AML-së.

Grafiku 27: Mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve në fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”




Grafiku 28 tregon se për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”, DRAP-et kanë mesatare pikësh më të ulët krahasuar mesataren në nivel kombëtar (6.17), përveç DRAP-it Korçë që e ka më të lartë (6.23).

Grafiku 28: Pikët mesatare për çdo DRAP - Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca




Grafiku 29 tregon se për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca”, ZVA-të që kanë mesatare pikësh më të lartë se mesatarja në nivel kombëtar 6.17 janë: Kolonjë, Vau i Dejës, Shijak etj. ZVA-të që e kanë mesataren e pikëve të njëjtë me mesataren kombëtare (6.17) janë: Fier, Delvinë, Mirditë etj., ndërkohë disa ZVA me mesatare më të ulët se mesatarja kombëtare janë: Tepelenë, Klos, Bulqizë etj.

Grafiku 29: Pikët mesatare për çdo ZVA - Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca



Në grafikun 30 paraqiten rezultatet e drejtuesve dhe të mësuesve për fushën “Planifikimi dhe zbatimit i kurrikulës me kompetenca”. Nga grafiku duket se kategoria mësues ka rezultate më të larta në nivelin 4, me 42.8%.


Grafiku 30: Rezultatet drejtues dhe mësues për secilin nivel-  
Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca



Informacioni për rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për fushën “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca” për secilin nivel paraqiten në grafikun 31.

Nga grafiku duket se mësuesit pa kategori (me më pak se 5 vjet punë) kanë rezultate më të larta në nivelin e parë (me nevoja të konsiderueshme për trajnim), rreth 47%. Gjithashtu edhe 35.6% e mësuesve të kategorisë së parë janë në nivelin e parë dhe të dytë, me nevojat të konsiderueshme për trajnim.

**Grafiku 31: Rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për secilin nivel - Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca**



### 4.3 Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”


Fusha “Mësimdhënia dhe të nxënit” është vlerësuar për nevojat për përditësim të njohurive dhe të aftësive që paraqesin mësuesit lidhur me metodologjitë e mësimdhënie-nxënies në kushtet e mësimit në klasë dhe në kushtet e mësimit në distancë (online), zhvillimin e kompetencave kyç për të nxënit gjatë gjithë jetës si dhe të aftësive parësore (soft skills), procesin e vlerësimit të të nxënit (përfshirë vlerësimin për të nxënë dhe vlerësimin e të nxënit), teknikat e të pyeturit dhe llojet e pyetjeve, përdorimin e situatave nga jeta reale në përvetësimin e njohurive dhe të aftësive, përdorimin e platformave online si metodologji mësimdhënieje, menaxhimin e klasës dhe sjelljen e nxënësve, si dhe klimën në klasë.

Në nivel kombëtar mesatarja e pikëve në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” është 5.7. Pikët maksimale në këtë fushë janë 9 pikë. Rezultati i pikëve mesatare në këtë fushë tregon se mësuesit kanë nevoja të domosdoshme për përmirësim të aftësive të tyre në këtë proces përfshirë edhe përdorimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënie – nxënies.


Nga informacioni i paraqitur në grafikun 32 rezulton se numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe me nivelin 2 për fushën e mësimdhënies dhe të të nxënit (47.5%) është ndjeshëm i lartë, ndërsa numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 4 është vetëm 18.1% (shihni tabelat në shtojcën 1).

Këto shifra tregojnë se rreth 47.5% e mësuesve zotërojnë informacion jo të mjaftueshëm për çështje që lidhen me procesin e mësimdhënie – nxënies në kurrikulën me kompetenca, si dhe në përdorimin e aftësive digjitale në procesin mësimor.


Grafiku 32: Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”



Grafiku 33 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga mësuesit për fushën e mësimdhënie - nxënies. Shihet se numri i mësuesve të vlerësuar me pikët maksimale të fushës (9 pikë) është i ulët (vetëm 2527 mësues) dhe pjesa më e madhe e mësuesve rezulton me 5 ose 6 pikë (8962 mësues ose 44.2%). Grafiku paraqet një shpërndarje normale të anuar pak nga e majta (në vlera  $5.7 \approx 6=6$ ). Grafikisht shihet se mesatarja e pikëve të fituara nga mësuesit (5.66) është më e lartë se mesatarja e pikëve të instrumentit për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” që është 4.5.



**Grafiku 34: Fusha “Mësimdhënia dhe të nxënit” për çdo DRAP**






Grafiku 34 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” për çdo DRAP. Nga të dhënat duket se në këtë fushë DRAP Lezhë ka një përqindje të lartë të mësuesve (më shumë se gjysma ose 51.25%) që janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, pasuar edhe DRAP Korçë me 47.35%.

Rezultate më të larta në këtë fushë ka DRAP Fier me 53.69% të mësuesve që janë në nivelin 3 dhe në nivelin 4 që do të thotë se mësuesit kanë aftësi të mira dhe shumë të mira për procesin e mësimdhënie – nxënies, pasuar edhe nga DRAP Durrës me 53.38% të mësuesve në këto nivele.

Grafiku 35: Mësimdhënia dhe të nxënit sipas zonës (urbane/rurale)




Grafiku 35 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” për zonat urbane dhe rurale.

Ashtu si për vlerësimin e fushës “Planifikimi dhe zbatimit i kurrikulës me kompetenca” edhe në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” rezulton se mësuesit e shkollave të zonave urbane kanë rezultate më të larta kundrejt mësuesve të shkollave të zonave rurale dhe kjo veçanërisht duke iu referuar numrit të mësuesve të vlerësuar me nivelin 3 dhe me nivelin 4, me rezultate të kënaqshme dhe shumë të kënaqshme. Ndërkohë 49.08% e mësuesve të zonës rurale janë në nivelin 1 dhe në nivelin 2, krahasuar më 46% të mësuesve të zonës urbane.


Grafiku 36 tregon mësuesit e profileve/lëndëve sipas niveleve përkatëse në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”. Nga të dhënat grafike rezulton se edhe në këtë fushë, në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë janë mësuesit e arsimit parashkollor me 62.3%, pasuar nga mësuesit e arsimit fillor me 52.5%, mësuesit ndihmës me 46.9%, mësuesit e TIK-ut me 46.2% etj.

Grafiku 36: Mësuesit sipas profileve/lëndëve dhe niveleve në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”




Grafiku 37 tregon mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve përkatëse në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”. Nga të dhënat grafike rezulton se edhe në këtë fushë mësuesit e arsimit parashkollor dhe mësuesit e arsimit fillor janë në përqindje të lartë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, me nevoja të domosdoshme për përmirësim.

Grafiku 37: Mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”




Grafiku 38 tregon se për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”, DRAP-et kanë mesatare pikësh të përafërt me mesataren (5.66) në nivel kombëtar, përveç DRAP-it Lezhë që ka mesatare më të ulët (5.53).

Grafiku 38: Pikët mesatare për çdo DRAP - Mësimdhënia dhe të nxënit




Grafiku 39 tregon se edhe për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” janë të njëjtat ZVA që kanë mesatare pikësh më të lartë se mesatarja (5.66) në nivel kombëtar (ZVA-të: Kolonjë, Divjakë, Delvinë, Përrenjas), ndërsa ZVA-të që kanë mesataren e pikëve të njëjtë me mesataren kombëtare, janë: Cërrik, Elbasan, Krujë, Kukës, Patos, Shkodër etj.

Grafiku 39: Pikët mesatare për çdo ZVA - Mësimdhënia dhe të nxënit




Në grafikun 40 paraqiten rezultatet e drejtuesve dhe të mësuesve për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”. Nga grafiku duket se në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”, rezultatet më larta i kanë drejtuesit, ndërsa 47.8% e mësuesve janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë duke treguar se kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim.

Grafiku 40: Rezultatet drejtues dhe mësues për secilin nivel -  
Mësimdhënia dhe të nxënit



Informacioni për rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit” për secilin nivel paraqitet në grafikun 41. Nga grafiku duket se në këtë fushë, mësuesit e kategorisë së dytë (10 vjet punë) kanë rezultate më të larta me 57.3%, ndërkohë që mësuesit e kategorisë së parë kanë rezultate më të ulëta (50.2% e tyre janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë).

Grafiku 41: Rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për secilin nivel - Mësimdhënia dhe të nxënit



#### 4.4 Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Etika dhe komunikimi”


Fusha “Etika dhe komunikimi” është vlerësuar për nevojat që paraqesin mësuesit lidhur me zbatimin e kodit të etikës, mënyrën e komunikimit me nxënësit sipas zhvillimit moshor të tyre, komunikimin me prindërit dhe përfshirjen e tyre në procesin mësimor, komunikimin me kolegët, bashkëpunimin me komunitetin dhe partneritetin mësues-nxënës –prindër.

Në nivel kombëtar mesatarja e pikëve në fushën “Etika dhe komunikimi” është 5.3, ndërkohë pikët maksimale në këtë fushë janë 6 pikë. Rezultati i pikëve mesatare në këtë fushë tregon se mësuesit kanë njohuri të mira në këtë fushë dhe vetëm 15% e tyre kanë nevoja të konsiderueshme për përmirësim të aftësive të tyre.

Nga informacioni i paraqitur në grafikun 42 rezulton se numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe me nivelin 2 për fushën e etikës dhe të komunikimit (15.5%) është ndjeshëm i ulët krahasuar me fushat e tjera, ndërkohë numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 4 është 54.9% (shihni tabelat në shtojcën 1).

Këto shifra tregojnë se rreth 84.5% e mësuesve zotërojnë informacion të mjaftueshëm për çështje që lidhen me etikën dhe me komunikimin.


Grafiku 42: Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Etika dhe komunikimi”




- Niveli 1 (Të pakënaqshme) (2.89%)
- Niveli 2 (Ka nevojë për përmirësim) (12.58%)
- Niveli 3 (Të kënaqshme) (29.66%)
- Niveli 4 (Shumë të kënaqshme) (54.86%)



Grafiku 43 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga mësuesit për fushën e etikës dhe të komunikimit. Shihet se numri i mësuesve të vlerësuar me pikët maksimale të fushës (6 pikë) është shumë i lartë (11131 mësues) dhe ndërkohë pjesa më e madhe e mësuesve rezulton me 5 ose 6 pikë (17149 mësues ose 84.5%). Grafiku paraqet një shpërndarje, e cila është shumë e spostuar nga e majta (në vlera  $5.3 < 6 = 6$ ). Grafiku shihet se mesatarja e pikëve të fituara nga mësuesit (5.28) është shumë më e lartë se mesatarja e pikëve të instrumentit për fushën e etikës dhe të komunikimit që është 3.



**Grafiku 44: Fusha “Etika dhe komunikimi” për çdo DRAP**




Grafiku 44 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Etika dhe komunikimi” për çdo DRAP. Nga të dhënat duket se në këtë fushë, DRAP Lezhë ka një përqindje më të lartë (18.54%) të mësuesve që janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, pasuar nga DRAP Korçë me 15.64%.

Rezultate më të larta në këtë fushë ka DRAP Fier me 86.01% të mësuesve në nivelin 3 dhe në nivelin 4 që do të thotë se mësuesit kanë aftësi të mira dhe shumë të mira për fushën “Etika dhe komunikimi”, pasuar nga DRAP Durrës me 85.2% të mësuesve në këto nivele.


Grafiku 45 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Etika dhe komunikimi” në zonat urbane dhe rurale. Ashtu si në vlerësimin e fushave të mësipërme, rezulton se mësuesit e shkollave të zonave urbane kanë rezultate më të larta kundrejt mësuesve të shkollave të zonave rurale dhe kjo veçanërisht referuar numrit të mësuesve të vlerësuar me nivelin 3 dhe me nivelin 4, me rezultate të kënaqshme dhe shumë të kënaqshme (85.78%), përkundrajt 83.18% të mësuesve në zonat rurale. Ndërkohë 16.82% e mësuesve të zonës rurale janë në nivelin 1 dhe në nivelin 2, krahasuar me 14.22% të mësuesve të zonës urbane.

Grafiku 45: Etika dhe komunikimi sipas zonës (rurale/urbane)




Grafiku 46 tregon mësuesit e profileve/lëndëve sipas niveleve përkatëse në fushën “Etika dhe komunikimi”. Nga të dhënat grafike rezulton se mësuesit e ekonomisë paraqesin një përqindje të lartë në nivelet 1 dhe 2 (38.8%), pasuar nga mësuesit e edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit (36.9%). Në përgjithësi mësuesit e profileve të tjera paraqesin rezultate të mira në nivelin e tretë dhe në nivelin e katërt.

Grafiku 46: Mësuesit sipas profileve/lëndëve dhe niveleve në fushën “Etika dhe komunikimi”




Grafiku 47 tregon mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve përkatëse në fushën “Etika dhe komunikimi”. Nga të dhënat grafike rezulton se mësuesit e arsimit parashkollor dhe mësuesit e kulturave artistike dhe sportive në shkollat me drejtim të orientuar kanë përqindje të larta në nivelet 1 dhe 2.

Grafiku 47: Mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve në fushën “Etika dhe komunikimi”



Grafiku 48 tregon se për fushën “Etika dhe komunikimi”, të gjitha DRAP-et kanë mesatare pikësh të përafërt me mesataren e pikëve (5.28) në nivel kombëtar, përveç DRAP-it Lezhë që ka një mesatare pikësh më të ulët (5.21).


Grafiku 48: Pikët mesatare për çdo DRAP – Etika dhe komunikimi



Grafiku 49 tregon se për fushën e etikës dhe të komunikimit, ZVA-të që kanë mesatare pikësh më të lartë se mesatarja (5.28) në nivel kombëtar, janë: Gjirokastër, Sarandë, Kolonjë, Delvinë, Kuçovë, Divjakë, Kavajë etj.


ZVA-të që e kanë mesataren e pikëve të njëjtë me mesataren kombëtare (5.28), janë: Berat, Elbasan Krujë, Shijak etj.

Grafiku 49: Pikët mesatare për çdo ZVA - Etika dhe komunikimi




Në grafikun 50 paraqiten rezultatet e drejtuesve dhe të mësuesve për fushën “Etika dhe komunikimi”. Nga grafiku vihet re se në fushën e etikës dhe të komunikimit drejtuesit kanë rezultate më të mira, por në të njëjtën kohë në nivelin e parë përqindja më e lartë është për kategorinë *drejtor*.

Grafiku 50: Rezultatet drejtues dhe mësues për secilin nivel - Etika dhe komunikimi



Informacioni për rezultatet e mësuesve sipas kategorisë, për fushën e etikës dhe të komunikimit, paraqitet në grafikun 51. Nga grafiku duket se rezultatet më të larta në nivelin e katërt (*shumë të kënaqshme*) i kanë mësuesit e kategorisë së dytë me 58%, pasuar nga mësuesit e kategorisë së tretë me 55.6%.

Grafiku 51: Rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për secilin nivel - Etika dhe komunikimi






## 4.5 Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”

Fusha “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” është vlerësuar për nevojat që paraqesin mësuesit lidhur me përditësimin e aftësive për konceptin e gjithëpërfshirjes, përkrahjen e diversitetit, trajtimin e nevojave të veçanta në shkollë, krijimin e mjedisit miqësor, trajtimin e bullizmit dhe integrimin në shkollë. Në nivel kombëtar mesatarja e pikëve në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” është 3.7, ndërkohë pikët maksimale në këtë fushë janë 6 pikë. Rezultati i pikëve mesatare në këtë fushë tregon se mësuesit kanë nevojë të domosdoshme në këtë fushë për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre. Vetëm 16.2% e tyre janë në nivelin 4, *me rezultate shumë të kënaqshme*.


Nga informacioni i paraqitur në grafikun 52 rezultojnë se numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe me nivelin 2 për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” është ndjeshëm i lartë (69.2%), krahasuar me fushat e tjera, ndërkohë numri i mësuesve të vlerësuar në nivelin 3 dhe në nivelin 4 është 30.8% (*shihni tabelat në shtojcën 1*).

Këto shifra tregojnë se rreth 16.2% e mësuesve zotërojnë informacion të mjaftueshëm për çështje që lidhen me gjithëpërfshirjen, ndërkohë që 83.8% e mësuesve kanë nevojë për përmirësim apo nevojë të domosdoshme për përmirësim.


Grafiku 52: Rezultatet e vlerësimit në nivel kombëtar për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”



Grafiku 53 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga mësuesit për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”. Shihet se numri i mësuesve të vlerësuar me pikët maksimale të fushës (6 pikë) është shumë i ulët (vetëm 3284 mësues) dhe ndërkohë pjesa më e madhe e mësuesve (12989 mësues ose 64%) rezulton me 2-4 pikë. Grafiku paraqet një shpërndarje normale (në vlera  $3.7 < 4 > 3$ ). Grafikisht shihet se mesatarja e pikëve të fituara nga mësuesit (3.7) është e ulët, gati në nivelin e mesatares së pikëve të instrumentit për fushën e etikës dhe të komunikimit që është 3.



**Grafiku 54: Fusha “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” për çdo DRAP**




Grafiku 54 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” për çdo DRAP. Nga të dhënat duket se në këtë fushë, DRAP Durrës ka një përqindje më të lartë (70.31%) të mësuesve që janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, pasuar edhe nga DRAP Lezhë me 69.92% të mësuesve.

Rezultate më të larta në këtë fushë ka DRAP Fier me 32.46% të mësuesve që janë në nivelet 3 dhe 4, që do të thotë se mësuesit kanë aftësi të mira dhe shumë të mira për fushën e gjithëpërfshirjes, pasuar edhe nga DRAP Korçë me 31.3% të mësuesve në këto nivele.

Grafiku 55 tregon rezultatet e mësuesve për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” për zonat urbane dhe rurale.


Ndryshe nga vlerësimi i fushave të mësipërme, në fushën e gjithëpërfshirjes rezulton se mësuesit e shkollave të zonave rurale në nivelin 4, me rezultate shumë të kënaqshme, kanë përqindje më të lartë (16.84%) kundrejt 15.58% të mësuesve në zonat urbane. Ndërkohë rezultatet e niveleve të tjera (1,2,3) janë të përafërta.

Grafiku 55: Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës sipas zonës (urbane/ rurale)




Grafiku 56 tregon mësuesit e profileve/lëndëve sipas niveleve përkatëse në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”. Nga të dhënat grafike rezulton se në këtë fushë pothuajse të gjithë mësuesit kanë nevojë të konsiderueshme për të përmirësuar aftësitë e tyre, pasi rezultatet në përqindje janë më të larta në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë.

Grafiku 56: Mësuesit sipas profileve/lëndëve dhe niveleve në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”




Grafiku 57 tregon mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve përkatëse në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”. I njëjti arsyetim vlen edhe për grafikun e mësuesve sipas cikleve dhe niveleve. Të gjithë mësuesit sipas cikleve kanë nevojë të konsiderueshme për trajnim në këtë fushë.

Grafiku 57: Mësuesit sipas cikleve shkollore dhe niveleve në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”



Grafiku 58 tregon se për fushën e gjithëpërfshirjes, DRAP-et që kanë mesatare pikësh më të lartë se mesatarja 3.75 në nivel kombëtar, është DRAP Fier me 3.83. DRAP-et që e kanë mesataren e pikëve më të ulët krahasuar me mesataren kombëtare, janë DRAP Durrës dhe DRAP DRAP Lezhë.


Grafiku 58: Pikët mesatare për çdo DRAP - Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës



Grafiku 59 tregon se për fushën e gjithëpërfshirjes, ZVA-të që kanë mesatare pikësh më të lartë se mesatarja (3.75) në nivel kombëtar janë: Gramsh, Korçë, Maliq, Sarandë etj.


ZVA-të që e kanë mesataren e pikëve të njëjtë me mesataren kombëtare (3.75) janë: Durrës, Elbasan, Fier, Lushnjë, Shkodër, Tropojë etj.

Grafiku 59: Pikët mesatare për çdo ZVA - Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës



Në grafikun 60 paraqiten rezultatet e drejtuesve dhe të mësuesve për fushën e gjithëpërfshirjes për zhvillimin e shkollës. Nga grafiku duket se kategoritë *mësues ndihmës* me 73,4% dhe *mësues* me 70% janë në nivelin e parë dhe në nivelin e dytë, pra kanë nevoja të domosdoshme për trajnim.


Grafiku 60: Rezultatet drejtues dhe mësues për secilin nivel - Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës





Informacioni për rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” dhe për secilin nivel paraqitet në grafikun 61. Nga grafiku duket se të gjithë mësuesit (për çdo kategori) kanë nevojë të konsiderueshme për trajnim.

Grafiku 61: Rezultatet e mësuesve sipas kategorisë për çdo nivel - Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës



# KONKLUSIONE

Zbatimi i reformës kurrikulare kërkon ndryshimin e rolit të mësuesit dhe të drejtuesit të shkollës, si dhe pritshmërinë ndaj tyre. Mësimdhënia dhe të nxënit me kompetenca nuk zhvillohet në “vakum”, por kërkon mësues të aftë për të lehtësuar të nxënit e nxënësve, si dhe për t’u siguruar atyre strategji, mjete dhe burime të përshtatshme për ta bërë të nxënit sa më efektiv. Arsimi gjithëpërfshirës, si një hap i parë drejt përfshirjes sociale, është në dobi të të gjithë shoqërisë. Përvoja e viteve të kaluara i dha një mësim të çmuar shoqërisë se veçimi i një pjese të fëmijëve në shkolla të veçanta ka efekte negative në jetën e tyre të mëtejshme, por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Në sistemin tonë arsimor parauniversitar, gjithëpërfshirja është bërë tashmë realitet, por është e shoqëruar me vështirësi të shumta.

Rezultatet e përpunuara nga të dhënat e mësipërme dhe interpretimet e tyre tregojnë se pjesa më e madhe e mësuesve kanë nevojë për trajnime të vazhdueshme dhe të qëndrueshme. Gjetjet nga përpunimi statistikor tregojnë se:

- Vetëm 22% e mësuesve dhe e drejtuesve zotërojnë njohuri të nivelit “Shumë të kënaqshme”. Pjesa më e madhe e tyre (54%) zotërojnë njohuri të nivelit “Të kënaqshme, por me nevoja për përmirësim të tyre”. **24% e mësuesve dhe e drejtuesve** kanë nevoja të domosdoshme apo të konsiderueshme për përmirësim.
- **Rezultatet më të ulëta janë arritur në fushën “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës”,** ku numri i mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe me nivelin 2 (nevoja të domosdoshme apo të konsiderueshme për përmirësim) arrin në shifrat **69.2%**.
- **Në fushën “Mësimdhënia dhe të nxënit”,** vetëm 18.1% e mësuesve paraqesin rezultate shumë të kënaqshme, ndërkohë që 47.5 % e **mësuesve dhe e drejtuesve** kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim dhe duhet të përmirësojnë në mënyrë të ndjeshme cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit.

- **Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës me kompetenca** është një fushë tjetër ku mësuesit paraqiten me nevoja të ndjeshme për përmirësim. **37.3 % e tyre** kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim, ndërkohë që **34.4%** kanë rezultate të mira, por kanë nevojë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë tyre në këtë fushë.
- Në pyetjen 4 të fushës së planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës me kompetenca ku kërkohet përdorimi i aftësive digjitale, rezulton se **94.2% e mësuesve dhe e drejtuesve** kanë dhënë përgjigje të pasaktë. Kjo nënkupton se një çështje e rëndësishme që ka nevojë për përmirësim është zhvillimi profesional i mësuesve në përdorimin e aftësive digjitale.
- Ndonëse në fushën e etikës dhe të komunikimit, mësuesit paraqiten më mirë krahasuar me fushat e tjera, përsëri **rezultatet e të dhënave** tregojnë se mësuesit kanë nevojë për përmirësim të aftësive dhe të vlerave që duhet të demonstrojë mësuesi në shkollë gjatë komunikimit me nxënësit, me kolegët, me prindërit dhe me komunitetin. Rreth **15.5% e mësuesve** kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim, ndërkohë që **29.7% e tyre** kanë nevojë për përmirësim në këtë fushë.
- Mesatarja e pikëve në vlerësimin e përgjithshëm është **20.8, nga 30 pikë** që ka instrumenti i plotë. Mesatarja e pikëve është relativisht e lartë edhe për tri fushat e vlerësimit: “Planifikimi dhe zbatimi i kurrikulës”, “Mësimdhënia dhe të nxënit”, “Etika dhe komunikimi”, ndërkohë që fusha “Gjithëpërfshirja për zhvillimin e shkollës” ka një mesatare të ulët.
- Rezultatet e mësuesve të shkollave të qytetit janë disi më të larta kundrejt rezultateve të mësuesve të shkollave të fshatit. **25.52% e mësuesve në fshat** kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim, kundrejt **22.07% të mësuesve të qytetit**. Kjo vlen si për vlerësimin e përgjithshëm, po ashtu edhe për fushat e planifikimit dhe të zbatimit të kurrikulës, mësimdhënies dhe të nxënit, etikës dhe komunikimit, ndërkohë që për fushën e **gjithëpërfshirjes për zhvillimin e shkollës**, rezultatet shumë të kënaqshme të mësuesve **të fshatit (16.84%)** janë më të larta se **mësuesit e qytetit (15.58%)**.
- Rezultatet e mësuesve të **shkollave publike dhe private** në nivelin 4, me rezultate shumë të kënaqshme, janë të përafërta: **22.5%** e mësuesve të shkollave publike dhe **23.8%** e mësuesve të shkollave private. Ndërkohë në nivelin 1, me rezultate të pakënaqshme, mësuesit e shkollave private kanë përqindje më të lartë (**4.8%**), krahasuar më mësuesit e shkollave publike (**3%**).
- Rezultatet e mësuesve femra janë më të larta kundrejt rezultateve të mësuesve meshkuj. **21.7% e mësuesve femra** kanë nevoja të konsiderueshme për trajnim, kundrejt **31.75% të mësuesve meshkuj**.
- Arsimi parashkollor dhe arsimi fillor, pasuar nga shkollat e bashkuara kanë rezultate më të ulëta. Përqindja e mësuesve të vlerësuar me nivelin 1 dhe me nivelin 2 arrin **mbi 50%** (mësuesit kanë nevoja të domosdoshme për përmirësim). Ky fakt u vu re si në vlerësimin e përgjithshëm, po ashtu edhe për katër fushat e vlerësimit.

- **Shkollat e AML-së** kanë rezultate më të larta. Ky fakt u vu re si në vlerësimin e përgjithshëm, po ashtu edhe për katër fushat e vlerësimit.
- **DRAP-et me rezultate më të larta** janë DRAP Fier, DRAP Durrës dhe DRAP Korçë, ndërkohë që DRAP Lezhë është nën mesataren e përgjithshme, si në vlerësimin e përgjithshëm ashtu edhe në vlerësimet e fushave.
- **Rreth 75.47 % e mësuesve të rinj** që nuk e kanë marrë akoma kategorinë (pra më pak se 5 vjet në arsim) ose kanë **kategorinë e tretë (76.14%)** janë në nivelin e tretë dhe në nivelin e dytë, pra me nevoja për përmirësim në të gjitha fushat. Ndërkohë informacioni tregon se mësuesit e kategorisë së parë janë më së shumti në nivelin e katërt dhe në nivelin e tretë (**76.92%**), pra kanë rezultate të kënaqshme dhe shumë të kënaqshme. Të gjithë mësuesit e çdo kategorie kanë nevoja të konsiderueshme në trajnim në fushën e gjithëpërfshirjes dhe të përdorimit të TIK-ut.
- **Kategoria e kualifikimit dhe pikët totale të instrumentit**, parimisht duhet të tregojnë se mes tyre duhet të ketë një lidhje të qëndrueshme, por duke u bazuar në statistika rezulton që mes tyre pothuajse nuk ka lidhje. Vlerat e koeficientëve të korelacionit[1] ( $r = .100$ ,  $p < 0.01$ ) tregojnë **se lidhja është e dobët**. Pra, ka mësues me disa vite pune në arsim që kanë rezultate të dobëta, ndërkohë që ka mësues me më pak vite në arsim që kanë rezultate më të larta.
- **Nëndrejtorët janë kategoria e punonjësve arsimorë** që kanë rezultate më të larta, krahasuar me drejtorët dhe me mësuesit. Megjithatë në fusha të caktuara mbizotërojnë me rezultate më të mira mësuesit.
- **Rezultatet e mësuesve të lëndëve bazë të kurrikulës shkollore**, Gjuhë shqipe e letërsi (23.6%) dhe Matematikë (26%), nuk dallojnë ndjeshëm mes tyre, por rezultatet më të larta në nivelin e katërt (**me rezultate shumë të kënaqshme**) u përkasin mësuesve të matematikës.
- **Rezultatet e pjesës së tretë të instrumentit** ku mësuesit kanë shprehur disa tema/ çështje për të cilat ata kanë nevojë më së shumti për trajnim, mund të përmbledhen: *mësimdhënia dhe të nxënit; zgjidhja e konflikteve në klasë; planifikimi ditor sipas niveleve; gjithëpërfshirja; bashkëpunimi dhe ndërveprimi; bashkëpunimi me kolegët; përdorimi i pajisjeve digjitale; planifikimi i testeve sipas niveleve; trajtimi i fëmijëve me aftësitë të kufizuara; njohja me kurrikulën e re; portofoli i nxënësit; platforma të mësimin online; menaxhimi i sjelljeve të nxënësve me vështirësi; vlerësimi për të nxënë; puna me klasa kolektive; vlerësimi sipas niveleve; teoritë e komunikimit; të nxënit ndërveprues; projekti kurrikular; marrëdhënia prind – mësues; mësimi në distancë; binjakëzime dhe shkëmbime eksperiencash me mësues të shkollave brenda dhe jashtë vendit; situata e të nxënit; braktisja e fshehtë. **Temat e përzgjedhura nga mësuesit përputhen më së miri me gjetjet e rezultateve të këtij raporti.***

# REKOMANDIME

Të gjithë mësuesve duhet t'u jepet mundësia të marrin pjesë në zhvillim profesional, gjë që i ndihmon ata "të ushqehen" dhe t'i përkushtohen nxënësve në progresin dhe në suksesin e tyre. Zhvillimi intensiv i vazhdueshëm profesional, i orientuar me standarde dhe me tregues të matshëm, ndihmon mësuesit të "rriten" dhe të vlerësojnë ecurinë e performancës së tyre. Mësuesia është profesioni më i rëndësishëm që ndikon në formimin e brezit të ardhshëm dhe duhet të formohet dhe të zhvillohet duke u bazuar në standarde, të cilat përcaktojnë se çfarë duhet të dijë çdo mësues, çfarë aftësish duhet të demonstrojë dhe nga ç'vlera e qëndrime duhet të karakterizohet.

Zbatimi i reformës kurrikulare në sistemin e arsimit parauniversitar kërkon përmirësimin e cilësisë së të nxënësve, në mënyrë që nxënësit të jenë të aftë të zgjidhin problemet komplekse të jetës së sotme, si në nivel personal ashtu edhe në nivel kombëtar e global. Ky konceptim i ri i kurrikulës që bazohet në kompetencat e të nxënësve gjatë gjithës jetës, kërkon mësues të cilët, gjithnjë e më shumë, janë krijues, hartues, përzgjedhës të materialeve mësimore, bashkëpunues dhe të përgjegjshëm. Gjithashtu ka shumë rrugë drejt arsimit gjithëpërfshirës. Këto rrugë mund të ndryshojnë nga një shkollë në tjetrën, pasi në varësi të kontekstit ata mund të hartojnë mjete për mjedisin gjithëpërfshirës në klasë.

Rekomandimet që dalin nga ky raport u drejtohen të gjithë grupeve të interesit në nivel qendror, rajonal, në nivel shkolle, si dhe institucioneve trajnuese. E rëndësishme është që këto rekomandime të merren në konsideratë, sepse ato janë të zbatueshme dhe të efektshme për përmirësimin e zhvillimit profesional të mësuesve dhe të drejtuesve. Struktura e rekomandimeve është bazuar kryesisht në konkluzionet e këtij raporti dhe në nivelet e trajnimit të mësuesve.

Bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e kësaj analize, rekomandohet:

## NË NIVEL SHKOLLE/KOPSHTI



### 1 *Analiza e rezultateve në nivel shkollë*

Të **analizohen rezultatet e të dhënave në nivel shkollë**, në përgjithësi, por edhe për secilën fushë, në mënyrë që të përgatiten plane të zhvillimit profesional të mësuesve për përmirësimin e aftësive të tyre, krahasuar me standardet e mësuesit.



### 2 *Zhvillimi i brendshëm profesional*

Të fuqizohet më shumë **zhvillimi i brendshëm profesional i mësuesve**, veçanërisht për fushat e gjithëpërfshirjes dhe të mësimdhënie – nxënies.



### 3 *Matje të vazhdueshme*

Të **realizohen pyetësorë në mënyrë të vazhdueshme** me mësues, nxënës dhe prindër për të kuptuar në mënyrë të vazhdueshme perceptimet e tyre mbi punën e mësuesve dhe mbi punën e stafit drejtues të shkollës lidhur me përmirësimin e procesit mësimor në fushat e gjithëpërfshirjes dhe të mësimdhënies



### 4 *Zhvillimi i aftësive digjitale*

Të organizohen trajnime të brendshme për **zhvillimin e aftësive digjitale** të mësuesve dhe përdorimin e tyre në procesin mësimor.



## 5 *Fokusi tek hartimi i planeve ditore*

Stafet drejtuese dhe mësuesit **të fokusojnë më shumë punën e tyre në hartimin e planeve** ditore, organizimin e orës së mësimi, realizimin e veprimtarive për të përmirësuar strategjitë e mësimdhënies dhe të nxënit, përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor.



## 6 *Mbështetje për mësuesit e rinj*

**Mësuesit e rinj me pak vite punë** në arsim, të cilët nuk i kanë fituar ende shkallët e kualifikimit dhe kanë rezultate jo të kënaqshme, **të mbështeten nga mësuesit me eksperiencë** brenda shkollës, por edhe në rrjetet profesionale. Është detyrë e drejtorit të shkollës të organizojë zhvillimin profesional të mësuesve të rinj dhe t'i mbështesë ata me literaturën e nevojshme për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.



## 7 *Fokusi edhe te mësuesit me eksperiencë*


Fokusi i stafeve drejtuese të jetë edhe **te mësuesit me eksperiencë** lidhur me nevojat specifike të tyre për trajnim, duke e bërë këtë trajnim më individual. Meqenëse vitet e vjetërsisë në punë nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me rezultatet e instrumentit, **rekomandohet që mësuesit e rinj me rezultate shumë të kënaqshme të angazhohen** në veprimtarinë e organizmave të shkollës duke shkëmbyer eksperiencën e tyre në fusha të caktuara me mësuesit me eksperiencë.

## NË NIVEL DPAP, DRAP-I DHE ZVA-JE




### 1 *Analiza e rezultateve në nivel DPAP, DRAP-i dhe ZVA-je*

**Të analizohen rezultatet e të dhënave në nivel DRAP-i dhe në nivel ZVA-je** për rezultatet e përgjithshme dhe për rezultatet e secilës fushë, në mënyrë që të përgatiten plane të zhvillimit profesional të mësuesve për përmirësimin e aftësive të tyre, krahasuar me standardet e mësuesit.



### 2 *Planifikimi i veprimtarive të rrjeteve profesionale*

**Në planet e veprimtarive të rrjeteve profesionale** të planifikohen tema që kanë lidhje me të gjitha fushat dhe çështjet e trajtuara në instrumentin e identifikimit të nevojave, por veçanërisht me çështje që kanë patur rezultate më të ulëta si: gjithëpërfshirja, metodat e mësimdhënies dhe strategjitë e të nxënit, zhvillimi i aftësive digjitale dhe përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor.



### 3 *Mbështetja dhe fuqizimi i punës së rrjeteve profesionale*

**Të mbështetet dhe të fuqizohet në vazhdimësi puna e rrjeteve profesionale**, për të siguruar zhvillim profesional të njëkohshëm, si në zonat rurale ashtu dhe ato urbane, në mënyrë që të bëhet pjesë e kulturës së mësuesve.





## 4 *Promovimi i modeleve pozitive*

Të promovohen **modelet pozitive të krijuara në shkolla** lidhur me punën e mësuesve të rinj apo me eksperiencë në të gjitha fushat e instrumentit, veçanërisht në çështje që kanë reflektuar rezultate të ulëta.



## 5 *Pëfshirja e mësuesve meshkuj në veprimtari trajnuese*

Rezultatet më të larta të mësueseve *femra* krahasuar me mësuesit *meshkuj* tregojnë angazhim dhe përkushtim më të lartë të mësueseve në veprimtaritë e zhvillimit profesional. **Mësuesit meshkuj të jenë më aktivë në këto veprimtari**, duke reflektuar në punën e tyre përmirësime në procesin mësimor.



## 6 *Fuqizimi i zhvillimit profesioanl në nivel rajonal dhe ZVA-je*

Të fuqizohet më shumë **zhvillimi i profesional i mësuesve në nivel rajonal dhe në nivel ZVA-je**, veçanërisht për fushat e gjithëpërfshirjes dhe të mësimdhënie - nxënies nëpërmjet funksionimit të rregullt të **rrjeteve profesionale** për të gjitha profilet e mësuesve, si formë e diskutimit, e ndarjes së ideve dhe e shkëmbimit të eksperiencave ndërmjet mësuesve. Rekomandohet që mësuesit **të hartojnë plane aktivitësh** për zhvillimin e tyre profesional **duke u bazuar në standardet profesionale** të mësuesit.



## 7 *Trajnime të përvitshme me mësuesit*

Të organizohen **trajnime të përvitshme me mësuesit që kanë kategorinë e kualifikimit** për të përditësuar aftësitë profesionale të tyre, lidhur me çështjet më të domosdoshme të trajtuara në udhëzuesit për zbatimin e kurrikulës me kompetenca, gjithëpërfshirjen dhe aftësitë digjitale.



## 8 *Fokusimi i punës specifike në profile të caktuara*

Mësuesit e profilit të arsimit parashkollor, të arsimit fillor, të edukimit fizik, sporteve dhe shëndetit kanë rezultate më të ulëta. Në këto kushte, njësitë arsimore vendore **të fokusojnë punën e tyre specifisht** me formimin e përgjithshëm të këtyre mësuesve, sipas çështjeve të sipërpërmendura.



## 9 *Angazhimi dhe pjesëmarrja e mësuesve të rinj*

Të nxitet **angazhimi dhe pjesëmarrja e mësuesve të rinj** (5 - 10 vjet eksperiencë pune) në veprimtari që synojnë përmirësimin e aftësive të tyre profesionale, lidhur me mësimdhënien dhe të nxënit, gjithëpërfshirjen dhe përdorimin e TIK-ut në procesin mësimor.

## NË NIVEL KOMBËTAR (MASR DHE ASCAP)



### 1 *Analiza në nivel kombëtar e raportit*

**Të analizohen në nivel kombëtar rezultatet e këtij raporti** dhe të informohen DPAP, DRAP-et dhe të gjitha ZVA-të, lidhur me nevojat për trajnim të mësuesve për periudhën në vijim.



### 2 *Programe dhe projekte në nivel kombëtar*

**Të nxiten programe dhe projekte në nivel kombëtar** lidhur me çështjet e identifikuara si të nevojshme dhe të domosdoshme në këtë raport.



### 3 *Pasqyrimi në strategjinë e zhvillimit të arsimit 2021-2027*

**Të planifikohen në strategjinë e zhvillimit të arsimit 2021-2027**, aktivitete për zhvillimin profesional të mësuesve që lidhen me fushat dhe çështjet e trajtuara në raportin për identifikimin e nevojave për trajnim të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar.



### 4 *Mbështetja e rrjeteve profesionale*

**Të mbështetet në vazhdimësi puna e rrjeteve profesionale**, me trajnime të vazhdueshme periodike lidhur me modulet e akredituara për çështjet e sipërpërmendura.



## 5 “Standardet profesionale të mësuesit”

Të organizohen **trajnime me mësuesit për “Standardet profesionale të mësuesit”** lidhur me formimin e përgjithshëm dhe formimin sipas profileve lëndore.



## 6 Trajnime me DRAP-et dhe ZVA-të

Të mbështeten **DRAP-et dhe ZVA-të me trajnime të përvitshme për mësuesit që kanë kategorinë e kualifikimit (mësues të rinj dhe me eksperiencë)** për të përditësuar aftësitë profesionale të tyre lidhur me çështjet më të domosdoshme për zbatimin e kurrikulës me kompetenca, gjithëpërfshirjen dhe aftësitë digjitale.



## 7 Bashkëpunimi i ASCAP-it me institucionet partnere

Të nxitet **koordinimi dhe bashkëpunimi i ASCAP-it me institucionet partnere** joqeveritare që mbështesin programe në fushën e edukimit dhe të zhvillimit profesional për të orientuar mbështetjen e tyre drejt fushave/tematikave të lartpërmendura, të identifikuara si prioritare në këtë raport.




## 8 *Plane vjetore për zhvillimin profesional*

**Të hartohen nga ASCAP plane vjetore për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë me module të akredituara** lidhur me fushat e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës, mësimdhënie- nxënies, vlerësimit të nxënësit, zhvillimit të aftësive digjitale dhe përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, gjithëpërfshirjes dhe përkrahjes së diversitetit, trajtimit të nxënësve me nevoja të veçanta, etikës dhe komunikimit, bashkëpunimit me komunitetin, përdorimit të platformave online në procesin mësimor (në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19).



## 9 *Programe të zhvillimit profesional të drejtuesve*

Në këtë proces u përfshinë edhe drejtorët e nëndrejtorët. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se drejtuesit e shkollave kanë nevojë për trajnime në çështjet e sipërpërmendura. Në këtë kuadër **rekomandohet që ASCAP dhe Shkolla e Drejtorëve të organizojnë programe të gjera të zhvillimit profesional të drejtuesve në shkolla** dhe t'i inkurajojnë ata të ndjekin module specifike trajnimi, të cilat e vënë theksin tek aftësitë e procesit mësimor. Pjesëmarrja aktive e drejtuesve është shumë e rëndësishme në këto lloj programesh. Ata duhet të inkurajohen për të dhënë sugjerime për zgjidhjen e problemeve ekzistuese, duke përdorur eksperiencat e tyre, të cilat mund të mbështeten në informacionin përkatës teorik dhe në gjetjet e këtij raporti.



## 10 *Orientimi i organizatave dhe i agjencive*

**Të orientohen organizatat dhe agjencitë trajnuese që të akreditojnë module trajnimi dhe të ofrojnë e të zhvillojnë trajnime të mësuesve** lidhur me çështje që lidhen me fushat e planifikimit dhe zbatimit të kurrikulës, mësimdhënie – nxënies, vlerësimit të nxënësit, zhvillimit të aftësive digjitale dhe përdorimit të teknologjisë në procesin mësimor, gjithëpërfshirjes dhe përkrahjes së diversitetit, trajtimit të nxënësve me nevoja të veçanta, etikës dhe komunikimit, bashkëpunimit me komunitetin, përdorimit të platformave online në procesin mësimor (në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19).



## 11 *Mbështetja e institucioneve të arsimit të lartë*

**Të mbështeten institucionet e arsimit të lartë (IAL) me informacionin e domosdoshëm** të këtij raporti që në kurrikulën e formimit fillestar të mësuesve dhe në modulet e hartuara prej tyre për trajnimin e mësuesve, të trajtohen çështje që lidhen kryesisht me planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës, mësimdhënie – nxënien, vlerësimin e nxënësit, zhvillimin e aftësive digjitale dhe përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor, gjithëpërfshirjen dhe përkrahjen e diversitetit, trajtimin e nxënësve me nevoja të veçanta, etikën dhe komunikimin, bashkëpunimin me komunitetin, përdorimin e platformave online në procesin mësimor (në kushtet e krijuara nga pandemia COVID-19).

# INSTRUMENTI I IDENTIFIKIMIT TË NEVOJAVE PËR ZHVILLIMIN PROFESIONAL TË PUNONJËSVE ARSIMORË

Bazuar në nenin 7 të udhëzimit nr. 1 datë 20.01.2017 "Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar me qëllim që të sigurojë informacion për nevojat për trajnim të punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar, ka hartuar instrumentin për identifikimin e këtyre nevojave.

Pjesëmarrja në këtë proces është përgjegjësi e çdo punonjësi arsimor, por gjithashtu është anonim. Informacioni do të përdoret vetëm për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional.

Lutemi të siguroni informacionin e kërkuar në mënyrë sa më të sigurtë. Faleminderit për kohën dhe mirëkuptimin tuaj!

\* Required

## PJESA I - TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

1. Ky instrument po plotësohet nga: \*

Smartphone (aparati celular)

Kompjuter (tavoline)

Laptop

Tablet

2. Ju jeni: \*

- Drejtor
- Nëndrejtor
- Mësues
- Mësues ndihmës
- Tjetër

3. Shkolla ku ushtroni profesionin, është: \*

- Publike
- Private

4. DRAP \*

- Durrës
- Fier
- Korçë
- Lezhë



DRAP Durrës

5. Zyra Vendore e Arsimit ku ndodhet shkolla juaj: \*

Durrës

Vorë

Shijak

Kavajë

Rogozhinë

Krujë

Kamëz

Tiranë

Mat

Klos

Dibër

Bulqizë

## DRAP Fier

6. Zyra Vendore e Arsimit ku ndodhet shkolla juaj: \*

- Fier
- Divjakë
- Lushnjë
- Roskovec
- Patos
- Vlorë-Himarë
- Mallakastër
- Selenicë
- Përmet-Këlcyrë
- Tepelenë
- Gjirokastër-Libohovë-Dropull
- Delvinë-Finiq
- Sarandë-Konispol

## DRAP Korçë

7. Zyra Vendore e Arsimit ku ndodhet shkolla juaj: \*

- Korçë-Pustec
- Librazhd
- Elbasan
- Prrrenjas
- Peqin
- Belsh
- Cërrik
- Kuçovë
- Ura Vajgurore
- Gramsh
- Pogradec
- Berat
- Maliq
- Skrapar-Poliçan
- Devoll
- Kolonjë

DRAP Lezhë

8. Zyra Vendore e Arsimit ku ndodhet shkolla juaj: \*

- Lezhë
- Malësi e Madhe
- Tropojë
- Has
- Shkodër
- Vaudejës
- Pukë-Fushë Arrëz
- Kukës
- Mirditë
- Kurbin

Të dhëna të përgjithshme

9. Emri i shkollës: \*

---

10. Zona ku ndodhet shkolla ku jepni mësim, është: \*

- Urbane
- Rurale

11. Lloji i institucionit ku punoni, është: \*

- Arsim parashkollor (kopësht/klasë përgatitore)
- Shkollë fillore
- Shkollë për arsimin e mesëm të ulët
- Shkollë 9-vjeçare
- Shkollë e mesme e bashkuar
- Gjimnaz
- Shkollë profesionale
- Shkollë me kohë të shkurtuar
- Shkollë speciale
- Shkollë me drejtim të orientuar gjuhësor
- Shkollë me drejtim të orientuar artistik
- Shkollë me drejtim të orientuar sportiv

12. Cikli ku jepni mësim, është: \*

- Arsimit parashkollor
- Arsimit fillor
- Arsimit i mesëm i ulët
- Arsimit i mesëm i lartë
- Arsimit i mesëm i ulët + arsimit i mesëm i lartë
- Arsimit profesional
- Arsimit special
- Kultura artistike
- Kultura sportive

13. Gjinia juaj: \*

Femër

Mashkull

14. Vite pune në arsim: \*

---

15. Viti i diplomimit në mësuesi: \*

---

16. Kategoria juaj e fundit e kualifikimit: \*

Nuk kam kategori

Mësues i kualifikuar (Kategoria III)

Mësues specialist (Kategoria II)

Mësues mjeshtër (Kategoria I)

17. Vlerësimi në testimin e fundit të kualifikimit është:

Shkëlqyeshëm

Shumë mirë

Mirë

Mjaftueshëm

Dobët

Nuk kam kategori

18. Lënda/profili ku jepni mësim: \*

- Arsim fillor
- Arsim profesional
- Arsim parashkollor
- Arsim special
- Biologji
- Ekonomi
- Art pamor
- Edukim fizik
- Muzikë
- Fizikë
- Shkenca sociale
- Gjeografi
- Anglisht
- Frëngjisht
- Gjermanisht
- Italisht
- Gjuhë shqipe dhe letërsi
- Greqisht
- Histori
- Kimi
- Matematikë
- Maqedonisht
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi
- Balet (shkolla artistike)
- Art pamor (shkolla artistike)
- Muzikë (shkolla artistike)
- Mësues ndihmës
- Tjetër



19. A keni përfituar certifikatë me kredite gjatë vitit 2020? \*

Po

Jo

### Trajnimet

20. Trajnimet me kredite që keni ndjekur, janë ofruar nga: \*

ASCAP

Agjencitë trajnuese të akredituara

Universitetet

Tjetër

PJESA II - IDENTIFIKIMI I NEVOJAVE FUSHA “PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I  
KURRIKULËS ME KOMPETENCA”

21. 1. Gjergji është një mësues që shpenzon shumë kohë për planifikimin e mësimdhënies dhe e zbaton në mënyrë korrekte atë. Megjithëse planifikimi i detajuar është një pjesë kritike e suksesit të mësimdhënies së tij, cila nga alternativat e mëposhtme përshkruan më mirë se çfarë duhet të bëjë ai për të shmangur efektet negative? \*

- A) Ai duhet përherë t'i qëndrojë strikt synimeve dhe veprimtarive të planifikuara për çdo mësim.
- B) Ai duhet të lejojë fleksibilitet brenda orës mësimore dhe të marrë parasysh idetë e reja të nxënësve.
- C) Ai duhet të ruajë modelet tradicionale të planifikimit të mësimit dhe të përmbledhë rezultatet në fund të çdo mësimi.
- D) Ai duhet të mos e ndryshojë planifikimin duke reflektuar idetë e reja të nxënësve në mësimet e ardhshme.

22. 2. Një mësues po planifikon të vlerësojë arritjet e nxënësve përmes një testi. Gjatë planifikimit të testit, hapi i parë që duhet të kryejë është: \*

- A) përcaktimi i llojit të pyetjeve që do të ketë testi;
- B) përcaktimi i rezultateve të synuara të të nxënit;
- C) hartimi i skemës së vlerësimit të testit;
- D) përcaktimi i nivelit dhe i gjatësisë së testit.

23. 3. Në programin mësimor, kompetencat lëndore zbërthehen: \* 1 pikë

- A) në njohuri, shkathtësi dhe rezultate;
- B) në rezultate të nxëni të kompetencave kyç;
- C) në njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera;
- D) në nivele arritjeje dhe rezultate të nxëni.

24. 4. Rezultatet e të nxënit janë udhërrëfyesi kryesor në procesin e 1 pikë planifikimit dhe të realizimit të veprimtarive të të nxënit. Një mësues që harton planin e një periudhe të caktuar, i referohet dhe përzgjedh rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç apo të lëndës: \*

- A) nga plani vjetor lëndor;
- B) nga programi mësimor përkatës;
- C) nga udhëzuesi kurrikular lëndor;
- D) nga plani mësimor.

25. 5. Në një testim përmbledhës, mësuesi synon të vlerësojë nivelin e arritjeve të nxënësve dhe për këtë ai duhet të hartojë një numër të caktuar pyetjesh në test. Mësuesi e përcakton numrin e pyetjeve dhe pikëve për një koncept, kapitull ose tematikë duke u bazuar: \*

- A) në peshën specifike që ky koncept, kapitull ose tematikë zë në programin lëndor;
- B) në programin orientues të lëndës në provimin kombëtar të arsimit bazë;
- C) në tekstin mësimor dhe materialet ndihmëse mësimore;
- D) në vështirësinë që kanë hasur nxënësit gjatë zhvillimit të kapitullit.

26. 6. Mësuesi ka planifikuar që të zhvillojë një projekt kurrikular me një temë të zgjedhur nga nxënësit. Ai u ka sugjeruar atyre që prezantimin ta realizojnë duke përdorur pajisjet digjitale. Njëri prej grupeve të punës e ka punuar shumë mirë projektin, por nxënësit paraqesin vështirësi në përdorimin e pajisjeve digjitale. Në këtë rast mësuesi: \*

- A) nuk e quan projektin të përfunduar dhe e vlerëson negativisht;
- B) e vlerëson projektin duke u ulur pikët për mosparaqitjen me anë të mjeteve digjitale;
- C) i ndihmon nxënësit të përdorin pajisjet digjitale për prezantimin e projektit;
- D) u kërkon atyre të përpiqen vetë dhe të bëjnë patjetër prezantimin me pajisje digjitale.

27. 7. Një ndër komponentët e procesit të planifikimit është përgatitja e mjedisit fizik të klasës në të cilën do të zhvillohet procesi mësimor. Cilin nga faktorët e mëposhtëm duhet të marrë së pari në konsideratë mësuesi kur planifikon organizimin fizik të klasës?

\*

- A) Shpërndarjen e nxënësve sipas niveleve të arritjeve.
- B) Përmbajtjen e lëndës dhe aftësitë që duhet të zhvillohen te nxënësit.
- C) Llojet e veprimtarive që mësuesi planifikon të zhvillojë.
- D) Nivelin e ndërveprimit shoqëror që mësuesi synon të nxisë.

28. 8. Bazuar në kurrikulën me kompetenca, situata e të nxënësit që planifikohet në planin ditor të mësuesit: \*

- A) është e detyruar të planifikohet në çdo orë mësimi;
- B) është pjesë e rezultateve të të nxënësit të orës së mësimi;
- C) planifikohet vetëm në planin tremujor të periudhës;
- D) lidhet me metodologjinë dhe organizimin e orës së mësimi.

29. 9. Një mësues i ri vëzhgoi një orë mësimi në klasën e një mësuesi 1 pikë me përvojë. Paraprakisht ai ishte njohur më parë me planin ditor të kësaj ore mësimi. Gjatë vëzhgimit ai vuri re që mësuesi e ndryshoi ecurinë e parashikuar të mësimi. Mësuesi pohoi se e bëri një gjë të tillë, pasi nga reagimet e nxënësve kuptoi që diçka nuk shkonte. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë? \*

- A) Mësuesi mund ta ndryshojë planin e mësimi, kur sheh që mësimi nuk shkon mirë ose kur nxënësit e kërkojnë ndryshimin.
- B) Mësuesi nuk mund ta ndryshojë në asnjë rrethanë planin e përgatitur.
- C) Mësuesi mund ta ndryshojë planin e parashikuar, vetëm kur ia kërkon ose e lejon drejtorja.
- D) Mësuesi mund ta ndryshojë planin gjatë zbatimit gjithmonë, rregullisht.

#### FUSHA “MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT”

30. 10. Një nga parimet e mësimdhënies me nxënësin në qendër 1 pikë është “Respektimi i diversitetit dhe i stilit të të nxënësit të fëmijëve”. Në kuptimin më të plotë ky parim do të thotë: \*

- A) të pranojmë që nxënësit janë të ndryshëm nga njëri-tjetri;
- B) të përshtatim mësimdhënien për çdo fëmijë, sipas stilit të tij të të nxënësit;
- C) të vlerësojmë diversitetin dhe stilet e të nxënësit dhe t'i shfrytëzojmë në dobi të përfitimit nga secili nxënësi;
- D) të lexojmë më shumë në lidhje me diversitetin dhe stilet e të nxënësit.

31. 11. Për të realizuar me efektivitet procesin e të nxënësve mësuesi përdor një sërë metodash dhe teknikash mësimore. Diagrami i Venit është një teknikë që mësuesi e përdor që nxënësit: \*

1 pikë

- A) të kujtojnë njohuritë e mëparshme rreth temës;
- B) të dallojnë ngjashmëritë dhe dallimet mes dy dukurive, koncepteve etj.;
- C) të kuptojnë saktësinë e informacionit që jepet në një tekst;
- D) të kuptojnë mjetet që përdor autori në një tekst për të qenë bindës.

32. 12. Arjana është një mësuese e re. Ajo është e shqetësuar, pasi vëren se nxënësit nuk përparojnë me ritmin e duhur dhe nuk arrijnë të organizohen në veprimtaritë në klasë. Cila nga veprimtaritë e mëposhtme do t'i sigurojë asaj të dhënat më efektive për të bërë një analizë të qartë të dobësive që paraqesin nxënësit në lëndën e saj? \*

1 pikë

- A) Diskutimi me prindërit e nxënësve.
- B) Diskutimi me kolegët e së njëjtës lëndë.
- C) Diskutimi me nxënësit për të kuptuar dobësitë që ato kanë.
- D) Rezultatet e testimit të nxënësve.

33. 13. Puna në grup është një nga metodat e përdorura shpesh që siguron ndërveprimin dhe bashkëpunimin e nxënësve. Cili është një nga disavantazhet e saj? \*

1 pikë

- A) Inkurajon ndërveprimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit në procesin e të nxënësve.
- B) Konkurrimi midis grupeve nxit produktivitetin gjatë orës së mësimin.
- C) Disa nga anëtarët e grupit mund të dominojnë mbi të tjerët.
- D) Nxënësit flasin, diskutojnë dhe punojnë më lirshëm.

34. 14. Po përgatisni një test për të vlerësuar arritjet e nxënësve për një periudhë të caktuar. Supozojmë se një nëntematikë në programin mësimor për atë periudhë zë 30% të programit. Ju do të hartoni një test me 30 pikë. Me sa pikë do të përfaqësohet kjo nëntematikë në test? \*

1 pikë

- A) 9 pikë
- B) 12 pikë
- C) 15 pikë
- D) 30 pikë



35. 15. Vlerësimi për të nxënë shpesh quhet vlerësim formues dhe 1 pikë  
është: \*

- A) vlerësim që mbledh të dhëna dhe dëshmi rreth të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit;
- B) vlerësim që mbledh prova që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj;
- C) vlerësim që mbledh të dhëna për suksesin e orës së mësimit;
- D) vlerësim përmbledhës që kryhet në fund të periudhës.

36. 16. Cili nga pohimet më poshtë NUK është karakteristikë e 1 pikë  
vlerësimin për të nxënë? \*

- A) Mësuesit, nxënësit, prindërit janë përdoruesit kryesorë të vlerësimin për të nxënë.
- B) Vlerësimin për të nxënë bëhet gjatë procesit të të nxënësve.
- C) Vlerësimin për të nxënë siguron informacione për çfarë dhe se si do të përmirësohet nxënësi.
- D) Qëllimi i vlerësimin për të nxënë është matja e arritjeve të nxënësve.

37. 17. Cili është avantazhi më i madh që ofron procesi i lidhjes ndërlëndore në veprimtaritë mësimore? \* 1 pikë

- A) Nxënësit kanë më pak gjasa për të zhvilluar antipati për fusha të veçanta.
- B) Mësuesit kanë më tepër fleksibilitet për të përdorur teknikat e punës në grupe.
- C) Nxënësve u jepet mundësi për të përgjithësuar dhe për të aplikuar njohuritë e sapo mësuara në kontekste të shumta.
- D) Mësuesit ndjehen më komod me shpjegimin dhe realizimin e veprimtarive mësimore.

38. 18. Llojet e pyetjeve drejtuar nxënësve janë të niveleve të ndryshme të vështirësive. Cila nga pyetjet e mëposhtme është e nivelit të lartë? \*

- A) Cili ishte?
- B) Me çfarë ju ngjan?
- C) Cilët janë faktorët e kësaj?
- D) Si e argumentoni ju?

FUSHA "ETIKA DHE KOMUNIKIMI"

39. 19. Në fillim të vitit shkollor, një mësues sheh se në klasën e tij ka 1 pikë nxënës të ardhur nga qytete dhe zona të ndryshme të vendit. Një nga mënyrat më të mira për të studiuar ngjashmëritë dhe dallimet mes kulturave të tyre do të ishte që këta nxënës: \*

- A) të marrin informacione nga një shumëllojshmëri burimesh për kulturat e tyre dhe t'i paraqesin me një përshkrim të shkurtër në formën e një raporti;
- B) të përshkruajnë dhe të krahasojnë kushtet e jetesës së qyteteve apo krahinave nga kanë ardhur;
- C) të krijojnë në klasë në orët e projekteve grupe të vogla heterogjene me përkatësi kulturore të ndryshme;
- D) të organizojnë një panair në formën e një projekti, ku të gjithë të paraqesin veçoritë e kulturës së zonave nga kanë ardhur (kostume popullore, foto, postera me figura të shquara nga të gjitha fushat, receta gatimi, postera me objektet dhe ndërtesat e rëndësishme të zonës nga kanë ardhur etj.).

40. 20. Për të shmangur konfliktet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve 1 pikë në fushën e vlerësimit mësuesi: \*

- A) duhet të bindë nxënësit në drejtësinë e vendimit të tij;
- B) duhet të mos lejojë diskutime me nxënësit për notën e vënë;
- C) duhet të bëjë të qarta që në fillim kriteret e vlerësimit të nxënësve;
- D) duhet të rishikojë çdo vlerësim që u bën nxënësve.

41. 21. Nxënësit e një klase sillen përgjithësisht mirë, me përjashtim të 1 pikë  
Emit. Emi ngrihet vazhdimisht pa leje nga vendi i saj, lëviz nëpër  
klasë, shqetëson nxënësit dhe komenton vrazhdë gjatë  
diskutimeve me shokët dhe shoqet e klasës. Cila është mënyra  
më e mirë që mësuesi të përmirësojë sjelljen e Emit? \*

- A) E nxjerr Emin para klasës sa herë që ajo gabon dhe e qorton për sjelljen e saj.
